

OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"

RAPORTI TEKNIK

***Objekti:* "Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Thatë, Njësia Administrative Fushë - Bulqizë, Bashkia Bulqizë".**

PROJEKT - ZBATIMI

VITI 2023

2ED **PROJEKTIM
DESIGN
SUPERVISION
KOLAUDIM**

Adresa: Rruga "Bardhyl", Njesia Bashkiake nr. 8, TIRANË



PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

A. Hyrje:

Objekti qe po trajtohet ne kete projekt ndodhet ne Bashkine Bulqize te Qarkut te Dibres, me nje popullsi prej 32,210 banoresh sipas censusit te 2011, qe i perket zones se Shqiperise Verilindore.

Ne kete zone mbizoteron pergjithesisht nje terren kodrionoro - malor.

Klima eshte e bute dhe me shume lageshti ne periudhen dimerore, qe shoqerohet me temperatura deri ne -10°C , ndersa temperatura mesatare vjetore eshte $10\div 20^{\circ}\text{C}$.

Me porosi te Bashkise Bulqize, eshte realizuar Projekti i Zbatimit per Rehabilitimin dhe Sistemimin e Perrojtit te Thate, i cili gjate periudhave me reshje te shumta vazhdimisht del nga shtrati i tij dhe permbyt tokat e shtepite perreth.

Ky investim eshte shume i nevojshem per permisimin e jeteses se banoreve te kesaj zone me nje infrastrukture bashkekohore.

B. Gjendja Aktuale e Objektit:

Perroi i Thate, i cili pavarsisht se nga emri mund te krijoje paqartesi, ne te vertete eshte nje perrua i cili vazhdimisht gjate periudhes se shirave te shumte ka prurje uji ne sasi te medha, e cila ka shkaktuar jo pak here permbytje te tokave dhe shtepive qe gjenden prane shtratit te tij.

Ky perrua me kalimin e viteve ka filluar gerryerjen e skarpatave anesore, si dhe daljen e tyre nga shtrati duke shkaktuar deme te konsiderueshme.

Perberja e shtratit te tij eshte nga gure te thate te permasave te ndryshme, me diameter nga 30 cm deri ne 200 cm, te cilet mund te shkaktojne dhe deme ne njerez e kafhse shtepiake me kalimin e kohes.

Per me teper, gjendja e rrezikshme qe paraqet Perroi i Thate mund te dallohet edhe nga fotot e meposhtme:

C. Foto nga Gjendja Aktuale:

OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"



OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"




OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"



OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"



OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"



ZGJIDHJA E PROJEKTIT

D. Mbrojtje me Gabiona:

Mbrojtja gjatësore është parashikuar të ndërtohet me gabiona me shufra lidhese me tel 4.5mm. Ky sistemi i gabionit, ka disa cilësi të vecanta, sic është teli i celikut që perdoret, është special, saldimi kryhet me kontakt, sipas nje teknologjie te avancuar (hapesira midis telave eshte 80 x 100 mm), veshja kunder ndryshkut eshte realizuar me ane të një përzjerje speciale zinku me alumin, që mbron nga korrozioni telat e rrjetës së gabionit, 3 here me shume sesa veshja prej zinku.

Lidhja e fortë e rrjetave të gabionit me njëra tjetrën së bashku, me sistemin e ri me shufër lidhëse, bëjnë të mundur formimin e saktë të qosheve. Një futje e saktë e shufrave lidhëse, garanton që të mos kemi hapje të strukturës dhe njekohësisht paraqitet nje siguri më e madhe. Me anë të shufrave lidhëse dhe koshave fqinjë, që varen dhe lidhen me njëra tjetrën, bëjnë strukturën e murit prej gabioni të qëndrueshme. Qëndrueshmeria e tyre, e krahasuar me betonin është e njëjtë. Përvec cilesive pozitive të mësipërme, ndërtimi i pritave me gabiona, ka kosto më të ulët. Prodhimi i gabionave, do të realizohet sipas standartit ndërkombëtar ISO 9001.

Guri që do të përdoret për të mbushur gabionat duhet të jetë gurë kave. Mbushja e koshave do të bëhet njëlloj sikur ndërtohet mur guri i thatë me gurë kave. Ndërtimi mbrojtjes gjatësore sipas projektit duhet të bëhet në periudhën e thatë të vitit, për të garantuar me përpikmeri në zbatimin e projektit dhe për të menjanuar dëmet nga prurjet eventuale të perroit.

Gjithashtu projekti mendon se vazhdimi i perdorimit të një teknologjie të re në ndërtimin e gabionave me shufra lidhëse, do të rriste më shumë sigurinë e ndërtimeve në llojin e tyre. Gabionat jane te dimensioneve te ndryshme si p.sh.:

Gabiona me përmasa 1x2x1 m dhe 1x1x1 m.

Gabionat janë parashikuar të jenë të montueshëm në vend.


Teli i gabionave është me diametër 3 mm i xinguar me përdredhje dy fishe me hapje hekzgonale 8x10 cm dhe me material xingato me peshë 350-450 gr/m², teli bordurës do të jetë 4 mm i xinguar me gjithë aksesoret, ndersa teli qepjes do të jetë 2.2 mm i xinguar me gjithë aksesoret.

Pesha e përafert për 1 m² është ≈ 2 kg/m².

Dimensionimi mureve gabion eshte realizuar sipas literatures: Gabion walls design, modular gabion systems a division of c.e. shepherd company 2221 canada dry street houston tx 77023 (literature e marre si shembull).

Me poshte paraqesim nje detaj tip te realizimit te mureve me gabion:

OBJEKTI: "REHABILITIM DHE SISTEMIM I PËRROJIT TË THATË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË – BULQIZË, BASHKIA BULQIZË"



PËRGATITI:

"2 ED" sh.p.k

Drejtues Teknik:

Ing. MARK PEMAJ

